



Pranuar / Dorezuar Prenheno/Prodato Received/Delivered	06 - 01 / 2021	9	viti god year
Organ / Shista Organ / Jednitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMSHUK	30/2021		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.370/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca- kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.370/2020, të datës 23.11.2020, të parashtruar nga [REDACTED], me adresë banimi në Podujevë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 6.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.370/2020 e datës 23.11.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED] nga Podujeva.

**A r s y e t i m**

[REDACTED] Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve pran Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve në Podujevë - Agjencia e Regjistrimit Civil, me datë 30.10.2020 përmes kërkesës me numër të protokollit 242/2020 drejtuar Menaxheres së Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka kërkuar kompensimin e një shume monetare në vlerën e një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes së anëtarit të familjes (motrës).

Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 03.11.2020 përmes e-mailit zyrtar, ka njoftuar ankuesin se me rastin e vdekjes së vëllaut apo motrës, të cilët nuk jetojnë në bashkësi familjare, nëpunësit civil nuk i takon kompensimi

Ankuesi, i pa kënaqur me përgjigjen e datës 03.11.2020 të Drejtorit të Drejtoratit për Pajisje në Dokumente në Agjencinë e Regjistrimit Civil, me datë 23.11.2020 ka parashtruar ankesën me numër A.nr 370/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 27.11.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministrinë e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 03.12.2020

ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën A.nr.370/2020 të datës 23.11.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2919/2020 të datës 03.12.2020 të organit të punësimit: Akt Emërimit të datës 06.12.2017; Certifikatën V 10359655 të datës 21.10.2020; E-mailin zyrtar të datës 01.12.2020; E-mailin zyrtar të datës 09.10.2020; E-mailin zyrtar të datës 10.09.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht Akt Emërimit me Nr.Ref:DRA/ARC 03/15 të datës 5.12.2017, Kolegji ka konstatuar se ankuesi [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve pranë Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve në Podujevë - Agjencia e Regjistrimit Civil. Ankuesi me datë 30.10.2020 përmes kërkesës me numër të protokollit 242/2020 drejtuar Menaxheres së Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka kërkuar kompensimin e një shume monetare në vlerën e një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, motrës [REDAKTUAR] [REDAKTUAR].

Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Drejtori i Drejtoratit për Pajisje me Dokumente në Agjencinë e Regjistrimit Civil, duke iu referuar Opinionit Ligjor të datës 09.10.2020 të lëshuar nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 03.11.2020 përmes e-mailit zyrtar, ka njoftuar ankuesin se me rastin e vdekjes së vëllait apo motrës, të cilët nuk jetojnë në bashkësi familjare, nëpunësit civil nuk i takon kompensimi.

Ankuesi në ankesën e dorëzuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon se Ministria e Punëve të Brendshme, me rastin e refuzimit të kërkesës së tij për kompensimin e një shume monetare në vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, për rastin e vdekjes së motrës, gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale kur është thirrur në dispozitat e Ligjit për Familjen, sepse kjo e drejte është e garantuar me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil. Po ashtu, ankuesi pretendon se çështja e përbërjes familjare duhet të interpretohet në harmoni me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, gjatë analizimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, ka gjetur se pushimet e nëpunësve civil, rregullohen sipas legjislacionit të punës, por jo edhe çështja e kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, andaj, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për njohjen e kësaj të drejte duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, është i pa bazuar.

Se kush përbën familjen, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vlerëson se duhet të merret për bazë përkufizimi i dhënë në Ligjin Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht neni 1 dhe 2 të këtij Ligji, që jep përkufizimin e familjes, si dhe neni 271 ku përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji.* Çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil, me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.

Andaj, bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatën V 10359655 të datës 21.10.2020, Kolegji ka konstatuar se [REDACTED], gjegjësisht motra e ankuesit, ka qenë e martuar, dhe në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se e ndjera ka qenë duke jetuar në bashkësi familjare me ankuesin, dhe nuk ka ndarë as ekonomi të përbashkët me ankuesin, kështu që Kolegji konsideron së pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, është i pa bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

Lënda me numër A.nr.370/2020.

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Jeton KOCA

*Jeton Koca*  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, [REDACTED],
- Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së